

 REPUBLIKA E KOSOVËS-REPUBLIKA KOSOVA-REPUBLIC OF KOSOVO MINISTRIA E MJEDISIT DHE PLANIFIKIMIT HAPËSINOR MINISTARSTVO ŽIVOTNE SREDINE I PROSTORNOG PLANIRANJA MINISTRY OF ENVIRONMENT AND SPATIAL PLANING	
Njësia Org. Org. Jedinica Org. Unit	Nr. Prot. Broj. Prot. Prot. No.: <u>4565/25</u>
Nr. i faqeve Broj. stranic No. pages	Data. Datum: Date: <u>08.04.2026</u>
PRISHTINË/A	



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Životne Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

Zyra e Sekretarit të Përgjithshëm / Kancelarija Generalnog Sekretara / Office of the General Secretary

DATË/A:	30.03.2026
REFERENC-Ë:	25/4565/MMPHI
PËR/ZA/TO:	“Joos Krasniqi Limited Construction” Sh.p.k. Meje, Gjakovë, Eksploatim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna e Junikut
CC:	Komisioni për shqyrtimin e kërkesave për Leje Mjedisore
PËRMES/PREKO/THROUGH:	Arkivës së MMPH-së
NGA/OD/FROM:	Bajram Kafexholli, U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Vendim për lëshimin e Lejes Mjedisore

Të nderuar/a,

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), ka shqyrtuar kërkesën për vazhdimin e Lejes Mjedisore të operatorit “Joos Krasniqi Limited Construction” Sh.p.k. Meje, Gjakovë, për veprimtarinë: Eksploatim i gurit gëlqeror, Shkoza, Komuna e Junikut.

MMPH, pas shqyrtimit të kërkesës të lartpërmendur, vizitës në teren, kërkesës për informata shtesë dhe mbajtjes së debatit publik me qytetar, ka vendosur si në Vendimin e bashkëngjitur:

Me respekt!

- T'i përmbahet me përpikmëri kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror vetëm në parcelat dhe sipërfaqen e lejuar, jashtë zonës së dytë të mbrojtur dhe zonës buferike të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna";
- Të mirëmbahet rrethoja e fushës eksploatuese;
- T'i përmbahet kushteve të shfrytëzimit të gurit gëlqeror, sipas përshkrimit në aplikacion;
- Për sistemin menaxhues mjedisor të këtë personin e profilit mjedisor;
- Vazhdimisht të bëhet spërkatja me ujë e rrugëve të pa asfaltuara, të cilat shfrytëzohen për bartjen e gurit gëlqeror nga fusha eksploatuese deri te lokacioni ku kryhet aktiviteti i thërrmimit dhe seperimit të gurit gëlqeror;
- Nëse gjatë operimit do të ketë ndonjë prishje teknike e që mund të ketë ndikim në mjedis dhe shëndetin e popullatës, të njoftoj MMPH-në;
- Pas përfundimit të aktivitetit të bëhet rehabilitimi dhe rikultivimi i zonës sipas kritereve ligjore dhe përshkrimit në aplikacion;

A r s y e t i m

Pas shqyrtimit të kërkesës për t'u pajisur me Leje Mjedisore, me Nr.Prot.25/4565/MMPHI, të operatorit "Joos Krasniqi Limited Construction" Sh.p.k. Meje, Gjakovë, për veprimtarinë: Eksploitim i gurit gëlqeror, në ngastrat kadastrale (numrat e rinj) nr. 336-3 dhe 338-5, jashtë zonës së dytë të mbrojtur dhe zonës buferike të Parkut Kombëtar "Bjeshkët e Nemuna" duke zvogëluar sipërfaqen e shfrytëzimit nga 5 hektar në 2.08 hektar, MMPH, konstaton se operatori i plotëson kriteret e parapara me Udhëzimin Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.01/2025 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr. 04/2022 për Leje Mjedisore, si dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

Operatori ka bashkangjitur dokumentet:

- Aplikacionin e plotësuar në një kopje fizike dhe një kopje elektronike (CD);
- Fletëpagesën, në bazë të Vendimit: Nr.13/99, te dt. 30.09.2022, për përcaktimin e kritereve dhe vlerat e tarifës për shërbimet lidhur me procedurat e shqyrtimit të kërkesave për leje mjedisore;



- Certifikatën e regjistrimit të biznesit, NUI 811125831 , datë: 08.09.2008, të lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë;
- Pëlqim Mjedisor me Nr.: 09/1071/1-ZSP-425/09, datë: 02.11.2009, të lëshuar nga Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor;
- Licencë Shfrytëzimi nga KPMM, 2072/KPMM/2020, me Nr.Prot.1577, datë: 28.04.2020, me kohëzgjatje deri më: 24.04.2032, të lëshuar nga Komisioni i Pavarur për Miniera dhe Minerale;
- Kopja e planit, 26.12.2025, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Junik;
- Certifikatë e njësisë kadastrale, nr.6-942/3-11093/25, datë:26.12.2025, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Junik;
- Raport i njësisë kadastrale, datë: 26.12.2025, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Junik;
- Raport teknik, datë: 27.12.2025, sipas matjeve të realizuara në terren nga Burim Halilaj, gjeodet i licencuar, Nr.licencës 195;
- Formular për korrigjimin e sipërfaqes, datë: 27.12.2025, sipas matjeve të realizuara në terren nga Burim Halilaj, gjeodet i licencuar, Nr.licencës 195;
- Kopja e planit e përditësuar,nr.6-942/3-606-26, datë: 23.01.2026, lëshuar nga Zyra Kadastrale Komunale Junik;
- Ekstrakt nga PZHK mbi parcelat kadastrale, Ref.6-351/1560, datë: 05.03.2026, lëshuar nga Drejtoria për Urbanizëm, Kadastër dhe Mjedis, Komuna e Junikut;

Andaj, Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH), duke u bazuar në nenin 31 të Ligjit Nr. 03/L-025 për Mbrojtjen e Mjedisit, Andaj bazuar në dokumentacionin e dorëzuar nga pala, gjendjes faktike në terren, mbajtjen e debatit publik, paragrafët 1, 2 dhe 4 të nenit 12 dhe nenin 13 të Udhëzimit Administrativ (MMPH) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore, Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, aprovon kërkesën për t'u pajisur me Leje Mjedisore të operatorit të lartcekur.

Leja Mjedisore lëshohet për periudhën pesë (5) vjeçare, në përputhje me paragrafin 4 të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ (MMPHI) Nr.04/2022 për Leje Mjedisore.

Leja Mjedisore mund të revokohet, pezullohet apo shfuqizohet në çdo kohë në rast se:

- Pëlqimet apo lejet paraprake mbi bazën e të cilave është lëshuar leja mjedisore janë revokuar, pezulluar apo shfuqizuar;
- Vërtetohet se pala nuk i ka respektuar obligimet e përcaktuara në leje mjedisore;
- Nëse konstatohet se operatori, ka dhënë shënime të pa sakta dhe deklarime të rrejshme;
- Nëse operatori nuk ka zbatuar dispozitat ligjore të legjislacionin në fuqi.

Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të inicioj konflikt administrativ me padi, në Gjykatën Themelore, në afat prej 30 ditësh, nga dita e pranimi të këtij vendimi.

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor

Nr.: 25/4565/ZSP/ /26 datë: 30.03.2026

Bajram Kafexholli

U.D. i Sekretarit të Përgjithshëm i MMPH-së

Vendimi t'iu dërgohet:

- Parashtruesit të kërkesës;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm;
- Komunës së Junikut;
- DMMU-së;
- Divizionit për Leje dhe Licenca Mjedisore;
- AMMK-së;
- Inspektoratit të MMPH-së;
- Kabinetit të Ministrit;
- Zyrës për komunikim me Publik të MMPH-së;
- Arkivit të MMPH-së